



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS - LIPJAN

PROPOZIM

STATUTI I KOMUNËS SË LIPJANIT

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunes, propozon që:

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, bazuar në nenin 12 par. 12.2 pika (a) dhe par. 12.3, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili është bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më, _____ miraton:

PROPOZIM

STATUTIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Kapitulli I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimi

1.1 Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës së Lipjanit, të cilin e miraton Kuvendi i Komunës sipas procedurës së përcaktuar. / Në tekstin e mëtejme Statuti/.

1.2 Statuti i Komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Lipjanit.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Statut rregullohet:

- Nocioni dhe kompetencat, statusi juridik, selia, simbolet dhe ditët e rëndësishme të veçantë për Komunën ,
- Vendbanimet e Komunës,
- Financat dhe pasuria e Komunës,
- Funksionimi dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve,
- Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës,
- Organizimi i administratës komunale,
- Shërbim civil komunal, dhe,

- Transparenca, konsultimet me publikun dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Neni 3

Komuna

3.1 Komuna e Lipjanit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila brenda territorit të saj ushtron pushtetin dhe përgjegjësitë, të cilat nuk janë rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. / Në tekstin e mëtejme Komuna /.

3.2 Komuna kujdeset që banorët e saj t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindjeje apo ndonjë statusi tjetër, me qëllim që ata gjithashtu të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet e Komunës në të gjitha nivelet.

Neni 4

Statusi juridik

Komuna është person juridik me të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie publike, për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykata, për të lidhë kontrata, për të punësuar si dhe për aktivitete tjera në përmbushjen e përgjegjësiave ligjore.

Neni 5

Selia

Selia e Komunës është e vendosur në qytetin e Lipjanit - Rruga "Shqipëria" nr.28.

Neni 6

Dita e Çlirimit

Dita e Çlirimit të Komunës është 12 Qershori 1999. Kjo ditë shënohet për çdo vit.

Neni 7

Simbolet

Komuna ka stemën, flamurin dhe vulat, përmbajtja dhe përdorimi i të cilave rregullohet me vendim të Kuvendit të Komunës, në pajtim me dispozitat kushtetuese e ligjore të Republikës së Kosovës.

Neni 8

Kompetencat e Komunës

Komuna i ushtron kompetencat vetanake dhe të deleguara në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. /Në tekstin e mëtejme Ligji/.

Neni 9

Kompetencat vetanake

Komuna ka kompetenca vetanake në pajtim me Ligjin, në fushat që vijojnë:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik,
- b) Planifikimin urban dhe rural,
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin e bujqësisë,
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit,
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal,
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësive lokale,
- g) Përgjigjet ndaj rasteve emergjente lokale,
- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve të arsimit,
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut,
- j) Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor,
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale,
- l) Banimin publik,
- m) Shëndetësinë publike,
- n) Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë,
- o) Emërimin e shesheve, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike,
- q) Turizmit,
- r) Aktivitetet kulturore dhe të lira, dhe
- s) Çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.

Neni 10

Kompetencat e deleguara

Komuna ushtron kompetenca të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, në fushat që vijojnë:

- a) Shënimet kadastrale,
- b) Regjistrimin civil,
- c) Regjistrimin e votuesve,
- d) Regjistrimin e biznesit dhe licencimin,
- e) Distribuirimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve),
- f) Mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjtve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria,

Neni 11 Organet e Komunës

Organet e Komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës - organi më i lartë i Komunës, dhe
2. Kryetari i Komunës - organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Neni 12 Gjuhët

12.1 Përdorimi i gjuhëve në Komunë rregullohet në pajtim me Ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve.

12.2 Kuvendi i Komunës miraton rregullore komunale të detajuara për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të Komunës, siç përcaktohet me ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Kapitulli II VENDBANIMET E KOMUNËS

Neni 13 Fshatrat dhe vendbanimet

Teritori i Komunës është përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ komunal. Komuna e Lipjanit përfshinë këto vendbanime:

1. Akillap
2. Babush i Muhaxherëve
3. Baicë
4. Banullë
5. Bregu i Zi
6. Brus
7. Bujan
8. Divlakë
9. Dobrajë e Madhe
10. Dobrajë e Vogël
11. Gadime e Epërme
12. Gadime e Ulët
13. Gllanicë
14. Gllavicë
15. Glllogoc
16. Grackë e Vjetër
17. Grackë e Vogël
18. Gumnasellë
19. Hallaq i Madh
20. Hallaq i Vogël
21. Hanrovc
22. Janjevë

23. Jeta e Re
24. Kleçkë
25. Kojskë
26. Konjuh
27. Kraishtë
28. Krojmir
29. Leletiq
30. Lipjan
31. Llugaxhi
32. Llugë
33. Magurë
34. Marec
35. Medvec
36. Mirenë
37. Plitkoviq
38. Poturoc
39. Pojatë (e njohur si Rubovc i Vogël)
40. Qellopek
41. Qylagë
42. Resinoc
43. Ribar i Madh
44. Ribar i Vogël
45. Rubofc
46. Rufc i Ri
47. Rufci Vjetër
48. Sillovi
49. Smallushë
50. Shalë
51. Teqe
52. Tërbuc
53. Topliqan
54. Torinë
55. Varigoc
56. Vërshec
57. Vrellë
58. Vrellë e Goleshit
59. Zllakuqan

Neni 14 **Marrëveshjet brenda Komunës**

14.1 Komuna brenda territorit të vetë bënë marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e nevojave të banorëve të Komunës.

14.2 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, vetëm apo në grupe, me pëlqimin e Komunës mund të ushtrojnë aktivitete që janë në përgjegjësinë e saj.

14.3 Marrëveshjet e përcaktuara në par. 14.1 dhe 14.2 të këtij neni, duhet të përmbajnë mënyrën dhe procedurat për kryerjen e punëve, burimet dhe lartësinë e

mjeteve të nevojshme, në pajtim me prioritetet që i ka përcaktuar Komuna në bazë të të hyrave buxhetore për vitin kalendarik.

14.4 Marrëveshjet nga paragrafët paraparak shqyrtohen dhe miratohen në Kuvendin e Komunës.

Neni 15

Shtrirja administrative në vendbanimet e Komunës

Komuna me vendim të Kuvendit, për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës Komunale.

Neni 16

Bashkëpunimi ndërkomunal

Komuna do të bashkëpunojë dhe do të krijojë partneritete me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda kompetencave të saj, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët, në pajtim me Ligjin.

Kapitulli III

PASURIA DHE FINANCAT E KOMUNËS

Neni 17

Pasuria e komunës

17.1 Komuna posedon dhe menaxhon pasuritë e saja të luajtshme dhe të paluajtshme.

17.2 Komuna ka të drejtë të shes dhe të jap me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

17.3 Komuna mban dhe udhëheqë regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që ka në shfrytëzim dhe posedim.

Neni 18

Financat komunale

18.1 Komuna ka Buxhetin dhe të hyrat financiare, për financimin e aktiviteteve të saj. Buxheti dhe financat komunale rregullohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe aktet tjera.

18.2 Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera.

Kapitulli IV

FUNKSIONIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Neni 19

Funksionimi dhe përgjegjësitë

19.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i Komunës i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët, në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

19.2 Kuvendi i Komunës së Lipjanit përbëhet nga 31 anëtarë.

19.3 Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit, të këtij Statuti dhe akteve tjera nënligjore.

19.4 Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë lidhur me marrjen e vendimeve të cekura në nenin 40 par. 40.2 të Ligjit, për fushat në vijim:

- a) Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
- b) Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese,
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës,
- d) Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor,
- e) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit,
- f) Zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit,
- g) Nivelin e taksave, tarifave dhe gjobave komunale,
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi,
- i) Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
- j) Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale,
- k) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe
- l) Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

19.5 Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Neni 20

Aktet e Kuvendit të Komunës

20.1 Kuvendi i Komunës miraton akte brenda kompetencave të tij në pajtim me dispozitat e nenit 12 të Ligjit. Këto akte përfshijnë:

- a) Statutin e komunës,
- b) Rregulloren e punës,
- c) Rregulloret komunale, dhe
- d) Çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.

20.2 Aktet e Kuvendit të Komunës vlejnë për territorin e Komunës.

20.3 Aktet e Kuvendit të Komunës hyjnë në fuqi brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe aktet nënligjore

Neni 21 Anëtarët e Kuvendit

21.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër vite.

21.2 Obligimet dhe të drejtat e anëtarëve të kuvendit realizohen në pajtim me dispozitat e nenit 39 të Ligjit dhe sipas rregullores për punën e Kuvendit.

21.3 Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar i Kuvendit sipas kushteve të parapara me nenin 37 par. 37.2 të Ligjit.

Neni 22 Informimi i anëtarëve të kuvendit për çështjet komunale

22.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, duhet të adresohen me shkrim tek organi kompetent i Komunës.

22.2 Organi kompetent i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të kuvendit të komunës.

22.3 Në rast se organi kompetent nuk e jep përgjigjen në afatin e paraparë sipas paragrafit paraparak, anëtari i Kuvendit mund të ngritë çështjen për sqarim në Kuvendin e komunës.

Neni 23 Konflikti i interesave

23.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë të obliguar të paraqesin konfliktet e interesit në pajtim me dispozitat e nenit 38 të Ligjit.

23.2 Nëse Kuvendi ose komiteti gjatë shqyrtimit të çështjeve të caktuara, konstaton ekzistimin e konfliktit të interesit të ndonjë anëtar, vendos me shumicë votash të anëtarëve prezent për përjashtimin e tij nga procesi i vendimmarrjes.

Neni 24 Mbledhja e parë dhe betimi i anëtarëve

24.1. Kuvendi i Komunës mbanë mbledhjen e parë inauguruese brenda 15 ditëve nga data e vërtetimit të rezultateve zgjedhore, sipas procedurës së paraparë me dispozitat e nenin 42 të Ligjit.

24.2 Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë deklaratën e betimit solemn.

24.3 Përmbytja e betimit solemn është si vijon: “Betohe me do t’i kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtarë i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.”

Neni 25

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

25.1 Kuvendi i Komunës e zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve të vet, me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur, sipas procedurës së përcaktuar me nenin 41 të Ligjit.

25.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Neni 26

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete

26.1 Kuvendi i Komunës cakton Zëvendëskryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete në pajtim me nenin 54 të Ligjit.

26.2 Zëvendëskryesuesi për komunitete kryen detyrat në pajtim me dispozitat e nenit 55 të Ligjit.

Neni 27

Rregullorja e punës

27.1 Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren e punës.

27.2 Me Rregulloren e punës saktësohen procedurat për thirrjen, udhëheqjen, ecurinë e mbajtjes së mbledhjeve, procesverbalin dhe procedurat e votimit.

27.3 Rregullorja e punës ose ndryshimet e saj konsiderohen të miratuara kur për këtë votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 28

Thirrja e mbledhjeve dhe përcaktimi i rendit të ditës

28.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit.

28.2 Rendi i ditës për mbledhjen e Kuvendit caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

28.3 Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

28.4 Kuvendi i Komunës thërret mbledhjet sipas Rregullores për punën e Kuvendit dhe mbanë së paku dhjetë (10) mbledhje të rregullta brenda vitit, pesë (5) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit.



28.5 Përveç mbledhjeve të rregullta, Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme në pajtim me dispozitat e nenit 44 të Ligjit.

28.6 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe për rendin e ditës, duhet të njoftohen së paku shtatë ditë pune, para mbledhjes të Kuvendit të Komunës, ose tri ditë pune më herët në raste urgjente. Njoftimet publike për këto çështje shpallen në të njëjtën kohë.

Neni 29

Kuorumi dhe mënyra e votimit

29.1 Kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij do të ekzistoj kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e përbërjes së Kuvendit, përkatësisht të komiteteve të Kuvendit.

29.2 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve, për çështjet që votohen, çdo anëtarë ka të drejtën e vetëm një vote. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ka votën vendimtare, në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.

29.3 Kuvendi i Komunës dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, ndërsa, me votim të fshehtë në rastet e parapara me ligj.

29.4 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve, nëse me ligj dhe me këtë Statut nuk parashihet ndryshe, merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë.

Neni 30

Procesverbali

30.1 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve mbahet procesverbal. Procesverbali duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me Rregulloren e punës.

30.2 Përmbajtja e procesverbalit aprovohet në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës.

30.3 Procesverbalin e miratuar e nënshkruan Kryesuesi.

Neni 31

Kompensimi

Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjin, nxjerr vendim për mënyrën dhe lartësinë e kompensimit të punës për anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin, Zëvendëskryesuesin e Kuvendit, si dhe për kryesuesit dhe anëtarët e komiteteve.

Neni 32

Komitetet e Kuvendit të Komunës

32.1 Kuvendi i Komunës themelon komitete të përhershme dhe komitete tjera për të cilat konsideron se janë të domosdoshme për kryerjen e përgjegjësiave të Komunës.

32.2 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e kuvendit të komunës.

Neni 33 **Komitetet e përhershme**

Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme.

Neni 34 **Komiteti për Politikë dhe Financa**

34.1 Komitetit për Politikë dhe Financa formohet prej anëtarëve nga përbërja e Kuvendit të Komunës, numri dhe struktura e të cilëve caktohet me vendim të Kuvendit.

34.2 Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike.

34.3 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Neni 35 **Komiteti për Komunitete**

35.1 Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve.

35.2 Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

35.3 Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 36
Komitetet tjera

Kuvendi i Komunës, përveç komiteteve të përhershme, me vendim, mund të themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

Kapitulli V
KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 37
Zgjedhja e Kryetarit të Komunës

37.1 Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët e Komunës që kanë të drejtë vote në përputhje me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.

37.2 Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare.

37.3 Mandati i Kryetarit të Komunës mund të përfundojë në rastet e parapara sipas dispozitave të nenit 56.3 të Ligjit.

Neni 38
Betimi

38.1 Kryetari i Komunës, pas zgjedhjes e jep betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

38.2 Forma e betimit solemn është si vijon: “Betohej se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Lipjanit me nderë, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

Neni 39
Shkarkimi

Kryetari i Komunës mund të shkarkohet në pajtim me dispozitat e nenit 64 të Ligjit.

Neni 40
Përgjegjësitë

Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj,
- b) Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës,
- c) Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij,
- d) Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës,
- e) Emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj,
- f) Emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) Organizon punën dhe drejton politikën e komunës,

- h) Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës,
- i) Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar,
- j) Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës,
- k) Mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve,
- l) Do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë dhe
- m) Aktivitete tjera të përcaktuara me dispozita ligjore.

Neni 41

Aktet e Kryetarit të Komunës

Në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit, Kryetari i Komunës nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda fushës dhe kompetencave të tij.

Neni 42

Konflikti i interesit

Kryetari i Komunës është i obliguar të paraqes konfliktet e interesit në pajtim me dispozitat e nenit 59 të Ligjit.

Neni 43

Nënkryetari i Komunës

43.1 Nënkryetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

43.2 Me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

43.3 Kur posti i Nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

43.4 Në raste të konfliktet të interesit të Nënkryetarit zbatohen dispozitat nga neni 37 të këtij Statuti

Neni 44

Nënkryetari i Komunës për komunitete

44.1 Komuna në pajtim me nenin 61 par. 61.1 të Ligjit do të ketë Nënkryetarin për komunitete jo shumicë.

44.2 Nënkryetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të Kryetari.

44.3 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

44.4 Nënkyetari për komunitete do t'i ndihmojë Kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për Kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

44.5 Kur posti i Nënkyetarit për komunitete mbetet i lirë, Kryetari propozon Nënkyetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të paragrafit 3 të këtij neni.

44.6 Në raste të konfliktet të interesit të nënkyetarit për komunitete zbatohen dispozitat nga neni 37 të këtij Statuti.

Kapitulli VI

ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 45

Organizimi i brendshëm

45.1 Administrata Komunale përbëhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoratet Komunale, Zyra e personelit dhe Njësia për Auditimin të brendshëm

45.2 Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoratet Komunale, Zyra e personelit dhe Auditori i brendshëm ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i Komunës të përcaktuara me dispozita ligjore dhe me këtë statut.

45.3 Në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të Drejtorateve mund të themelohen sektorët.

45.4 Zyrën e Kryetarit të komunës e udhëheqë Kryetari në mënyrë të drejtëpërdrejt, Drejtoratet i udhëheqin drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës, Sektorët i udhëheqin shefat e sektorëve, ndërsa Zyren e personelit - Udhëheqësi i personelit.

45.5 Drejtorët udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit në pajtim me Ligjin dhe rregulloret komunale në fuqi.

45.6 Drejtorët e drejtorateve i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështje që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Neni 46

Zyra e Kryetarit të Komunës

Zyra e Kryetarit të Komunës është e organizuar në njësi, sektorë dhe zyre konkrete që hyjnë në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të Kryetarit që kryejnë punët dhe ushtrojnë përgjegjësitë që ndërlidhen kryesisht me çështjet ligjore, të përfaqësimit, pronëso-ro-juridike, auditimit të brendshëm , marrëdhënies me publikun , mbrojtjes dhe

realizimit të drejtave të komuniteteve, burimeve njerëzore dhe punë të tjera të ngjashme në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 47 **Drejtoratet komunale**

Komuna me këtë Statut themelon drejtoratet komunale, me emërtime si vijon:

1. Drejtorati për Administratë,
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
3. Drejtorati për Arsime,
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport,
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim,
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.
9. Drejtorati për Infrastrukturë ,
10. Drejtorati për Inspeksion,
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari,
12. Drejtorati për Shërbime Publike ,Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe
13. Drejtorati për Prokurim.

Neni 48 **Drejtorati për Administratë**

Drejtorati për Administratë kryen punët dhe ushtron këto përgjegjësi:

- a) Kryen punët teknike-administrative dhe juridike për përgatitjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij,
- b) Bënë pranimin dhe dërgimin e shkresave të organeve dhe kërkesave të palëve të cilat u drejtohen organeve të komunës duke përfshirë dhënien e ndihmës dhe udhëzimeve juridike,
- c) Kryen punët nga lëmi i gjendjes civile,
- ç) Bënë ruajtjen dhe arkivimin e lëndëve të organeve të komunës;
- d) Kryen shërbime të përkthimit dhe
- dh) Kryen punët e mirëmbajtjes të objekteve dhe zyrave të punës, teknologjisë informative, të ruajtjes së objekteve të administratës komunale dhe të shërbimeve të transportit për udhëtime zyrtare.
- e) Koordinon politikat e Komunës në fushën e të drejtave të njeriut, respektim të barazisë gjinore, të drejta të komuniteteve, përdorim të guhëve, mundësi të barabarta etj.

Neni 49 **Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**

Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ushtron përgjegjësitë që i ka komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i shëndetësisë primare dhe përkujdesjes sociale:

- a) Kryen punët dhe është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të kujdesit parësor shëndetësor si dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të komunës,

- b) Kryen punët në zbatimin e kujdesit shëndetësor parësor duke iu dhënë përparësi masave për realizimin e politikave zhvillimore lidhur me planifikimin, organizimin dhe parandaluese shëndetësore nëpërmjet konceptit të mjekësisë familjare,
- c) kujdeset që komuna të realizoi politikat zhvillimore lidhur me planifikimin, organizimin, dhe financimin e kujdesit shëndetësor;
- ç) Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, qendrave të mjekësisë familjare, ambulancave dhe veprimtarisë private shëndetësore,
- d) Siguron përkujdesje ndaj kategorive të dala nga lufta, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së,
- dh) Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës për Punë Sociale,
- e) Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Shtëpisë së Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në Lipjan
- ë) Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët,
- f) Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 50 Drejtoria për arsim.

Drejtoria për Arsim ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i arsimit:

- a) Planifikon zhvillimin e arsimit në Komunë dhe aftësimin e personelit mësimor, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë,
- b) Nxistë bashkëpunimin e personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit,
- c) Siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse,
- ç) Merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve dhe kuadrit arsimor të shkollave,
- d) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i arsimit

Neni 51 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i rinisë, sportit dhe kulturës:

- a) Menaxhon me objektet komunale të kulturës sportit dhe rinisë,
- b) Planifikon dhe organizon aktivitete kulturore, sportive dhe rinore,
- c) Organizon tribuna për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë,
- ç) Mban shënime mbi të arriturat kulturore, sportive dhe rinore,
- d. Bën pranimin, evidencimin, ruajtjen dhe klasifikimin e materialit Arkivor të Komunës.
- dh) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 52
Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i financave:

- a) Bënë përgatitjen e projektit të buxhetit në procedurën e propozimit nga Kryetari i Komunës për miratim në Kuvend;
- b) Është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare periodike dhe vjetore;
- c) Është përgjegjëse për menaxhimin e thesarit;
- ç) Është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;
- d) Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- dh) Ndihmon organet e Komunës në planifikimin e mjeteve buxhetore;
- e) Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën), nga lëmi i tatimit në pronë, taksave, dhe gjobave Komunale;
- ë) Mbanë evidencën e të hyrave buxhetore nga të hyrat vetanake të Komunës;
- f) Kryen edhe punë tjera nga fushëveprimtaria e drejtoratit.

Neni 53
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ushtron përgjegjësitë që ka Komuna nga lëmi i zhvillimit ekonomik të Komunës:

- a) Harton projektin e planit strategjik dhe zhvillimor të Komunës;
- b) Harton plane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës;
- c) Harton plane për shfrytëzimin e burimeve ekonomike brenda Komunës;
- ç) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- d. Përcjellë legjislacionin e politikave standarde për partneritetin publiko-privat, dhe gjithashtu bën iniciimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve të partneritetit publiko privat
- dh) Kryen edhe punë të tjera të ndryshme nga kompetenca e Komunës në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse në fushën zhvillimit ekonomik, partneritetit publiko privat dhe integriteteve evropiane

Neni 54
Drejtoria për planifikim, urbanizëm, dhe mbrojtje të mjedisit

Drejtoria për planifikim, urbanizëm, dhe mbrojtje të mjedisit ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i planifikimit, urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit, si vijon:

- a) Harton planin e zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të Komunës,
- b) Vendosi sipas kërkesave për dhënie të lejeve të ndërtimit,

- c) Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të Komunës,
- ç) Kujdeset që të gjitha dokumentet e planifikimi hapësinor të nivelit lokal të jenë në harmoni me Hartën Zonale të Komunës dhe legjislacionin në fuqi,
- d) Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit
- dh) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e planifikimit, urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Neni 55

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i gjeodezisë dhe kadastrit, si vijon:

- a) Mban regjistrin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës komunale,
- b) Mban evidencat dhe hartat kadastrale për tokën dhe ndërtesat në territorin e Komunës,
- c) Bënë matjet kadastrale, regjistron të dhënat kadastrale dhe lëshon dokumentet përkatëse sipas kërkesave të palëve, dhe
- d) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e kadastrit dhe gjeodezisë.

Neni 56

Drejtoria për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim

Drejtoria për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i shërbimeve publike, mbrojtjes dhe shpëtimit, si vijon:

- a) Kujdeset dhe monitoron funksionimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me rrymë elektrike, funksionimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndriçimit publik;
- b) Kujdeset dhe monitoron funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, sipërfaqeve të gjelbëruara, të shfrytëzimit të sipërfaqeve të lira publike në pronësi të Komunës, të parkingjeve dhe të mirëmbajtjes së varrezave,
- c) Kujdeset dhe monitoron mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimit të qytetit dhe të vendbanimeve;
- ç) Propozon çështjet përkitazi me rregullimin e transportit urban dhe autotaksi të udhëtarëve;
- d) Kujdeset dhe monitoron funksionimin e tregjeve;
- dh) Kujdeset, planifikon dhe mbikëqyrë masat e ndërmarra për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore,
- e) Ofron shërbimet e zjarrfikësve dhe të emergjencës për ofrimin e mbrojtjes dhe të ndihmës nga fatkeqësitë elementare,
- ë) Në sferën e emergjencës bashkëpunon me organizatat joqeveritare-institucionet shëndetësore, lokalitetet urbane dhe rurale në rastet e zjarreve, vërshimeve, tërmeteve dhe fatkeqësive tjera elementare,
- f) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i shërbimeve publike, mbrojtjes dhe shpëtimit.



Neni 57
Drejtorati për inspeksion

Drejtorati për inspeksion kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore të mbikëqyrjes, në kuadër të së cilës funksionojnë inspeksionet, si vijon: i tregut, sanitar, i mjedisit dhe ambientit, i trafikut, i ndërtimtarisë, i bujqësisë dhe inspeksionet tjera komunale të përcaktuara me ligj.

Neni 58
Drejtorati për bujqësi dhe pylltari

Drejtorati për bujqësi dhe pylltari kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë dhe pylltarisë, si vijon:

- a) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë,
- b) Kujdeset të sigurojë që toka bujqësore të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore,
- c) Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Komunës, kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore,
- ç) Kujdeset që toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera e cila nuk ka karakter të përhershëm, t'i kthehet destinimit të parë, përkatësisht të aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projekteve për rikultivim,
- d) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e fondit të pyjeve,
- dh) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë dhe pylltarisë.

Neni 59
Drejtorati për Infrastrukturë

Drejtorati për Infrastrukturë kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi infrastrukturës, si vijon:

- a. Menaxhon projektet komunale ,
- b. Harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale,
- c. Përcjell dhe analizon rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore,
- ç. Është përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratave të ndërtimit, rindërtimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kablllore, ujësjellës, asfaltimin, ndriçimin publik, në qytet dhe vise rurale,
- d. Është përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratave të ndërtimit të objekteve të mëdha të infrastrukturës në pronësi publike të komunës.

dh. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtoratit.

Neni 60 Drejtorati për prokurim

Drejtorati për prokurim kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i prokurimit, si vijon:

- a) Kujdeset që në mënyrë efikase, të drejtë dhe transparente të zbatohen procedurat me rastin e shfrytëzimit të mjeteve publike të cilat i posedon Komuna si autoritet publik dhe kontraktues i prokurimit,
- b) Ndërmerr masa që Komuna si autoritet kontraktues të përgatitë planifikimet paraprake të prokurimit me shkrim, në të cilat identifikohen në detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokuroj gjatë vitit,
- c) Kujdeset që të mbanë shënime të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që kryen, pa marr parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënie të kontratës ose konkursit të projektimit, dhe
- ç) Kujdesët që gjatë zbatimit të aktiviteteve të prokurimit të zbatoj në mënyrë të drejtë procedurat e parapara të prokurimit,
- d) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i prokurimit.

Neni 61 Përgjegjësitë e drejtorëve

Drejtorët e drejtorateve komunale janë përgjegjës:

- a) Për kryerjen efikase të punëve dhe përgjegjësi nga fushëveprimtaria e përcaktuar me dispozita ligjore dhe me këtë Statut,
- b) Për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së drejtorateve dhe stafin që punues,
- c) Përgatitin dhe prezantojnë planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe realizimin e këtyre planeve,
- ç) Ndihmojnë dhe marrin pjesë në kryerjen e punëve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij dhe Kryetarit të Komunës,
- d) Sigurojnë informata dhe ndihmë administrative për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës lidhur me sferat e tyre të përgjegjësisë, të nevojshme për punën si anëtarë të Kuvendit,
- dh) Sigurojnë ofrimin e një qasjeje të drejtë dhe të barabartë për ato shërbime publike që bien në përgjegjësinë e tyre,
- e) Bëjnë vlerësimin e punës të stafit në pajtim me rregullat e Shërbimit civil, dhe
- ë) Kryejnë edhe punë tjera dhe ushtrojnë përgjegjësi nga fushëveprimtaria e drejtoratit.

Kapitulli VII

SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 62

Shërbyesi civil

Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, roga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- a) Kryetarit, nënkryetarit/ve dhe drejtorëve komunal,
- b) Kryesuesit, zëvendëkryesuesit/ve dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 63

Udhëheqja

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të Komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të Komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 64

Udhëheqësi i personelit

Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të Shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

Neni 65

Punësimi

65.1 Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

65.2 Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar.

Kapitulli VIII

TRANSPARENCA, KONSULTIMET ME PUBLIKUN, DHE MEKANIZMAT E PJESEMARRJES SË QYTETARËVE

Neni 66

Transparenca

66.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të Kuvendit janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e medieve.

66.2 Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij, mund të vendosin për mospjesëmarrje të publikut në mbledhje ose një pjesë e sajë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e medieve, në rastet kur natyra e çështjeve që shqyrtohen mund të marrë përmasa të dëmshme për interes të përgjithshëm publik.

66.3 Personat e interesuar mund të kërkojnë shikimin, përkatësisht kopjen e dokumenteve të Komunës në pajtim me procedurat e ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

66.4 Komuna themelon organin e informimit përmes të cilit bënë publikimin rregullativës, aktiviteteve si dhe të arriturave nga lëmi të ndryshme.

Neni 67

Konsultimet dhe pjesëmarrja e publikut

67.1 Komuna me rastin e marrjes së vendimeve dhe miratimit të rregulloreve nga kompetenca e vet, paraprakisht do të konsultoj publikun, në mënyrë që të merren parasysh sugjerimet dhe propozimet e publikut.

67.2 Komuna shfrytëzon format e konsultimit të publikut, si vijon:

- a) Publikimi i projekteve të akteve dhe rregulloreve në organin e informimit të Komunës, në tabelën e shpalljeve dhe në Web-faqen e Komunës,
- b) Organizimi i konsultave me publikun-grupeve të interesuara për të cilat ka të bëjë çështja e caktuar para se të miratohen në Kuvend dhe
- c) Organizimi i tryezave dhe anketave me qytetarë.

67.3 Komuna, gjatë vitit do të organizoi së paku dy takime me publikun dhe do të ndërmarr edhe masa tjera lidhur me informimin publik dhe konsultimin e publikut të parapara me dispozitat e nenit 68 të ligjit.

Neni 68

Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve

68.1 Qytetarët e komunës dhe subjektet tjera, i realizojnë të drejtat e tyre të demokracisë të drejtpërdrejtë nëpërmes të formave të prezantimit të petitionit, të ndërmarrjes së iniciativave të qytetarëve kërkesës për mbajtjen e referendumit, si dhe iniciativave të tjera, për çështjet të cilat janë në interes të qytetarëve nga përgjegjësitë dhe kompetenca e Komunës.

68.2 Kuvendi i Komunës në afatë prej katërdhjetëditësh (40) e shqyrton petitionin në mbledhjen e vet të rregullt.

Neni 69

Komitetet konsultative

Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat e nenit 73 të ligjit themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes.

Kapitulli IX
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 70
Procedura e miratimit

Statuti i Komunës dhe ndryshimet e tij, miratohen në Kuvend, kur për të votojnë dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 71
Dispozitat mbizotëruese

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij statuti me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitat e Ligjit mbizotërojnë.

Neni 72
Hyrja në fuqi

Ky statut hynë në fuqi (shtatë) 7 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës .

Neni 73
Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i Komunës INr. 110-623 i datës 26.09.2008 dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 15Nr.110-8393 i datës 11.07.2012 dhe dispozitat e rregulloreve Komunale në pjesët ku janë në kundërshtim me këtë statut.

Neni 74
Harmonizimi i akteve të Komunës me Statutin

Të gjitha aktet e Komunës, brenda gjashtë muajve, duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij statuti.

Neni 75
Interpretimi

Interpretimi autentik i këtij statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e Propozim –Statutit të Komunës së Lipjanit është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Propozimi për ndryshimin e Statutit komunal bëhet kryesisht me qëllim të harmonizimit me dispozitat ligjore në fuqi.

Me këtë Projekt Statut janë bërë disa ndryshime nga Statuti aktual konkretisht te dispozita e nenit 13 - Vendbanimet e Komunës janë bërë disa ndryshime me qëllim të

harmonizimit me legjislacionin e zbatueshëm përkatësisht me dispozitat e Ligjit për kufijtë administrativ komunal ku 8 vendbanime të Komunës së Lipjanit si Dobratini, Gushtericë e Epërme, Gushtericë e Ulët, Lepi, Livagjë, Radevë, Skullan dhe Suhadoll kanë kaluar nën administrimin e Komunës së Graçanicës .

Me këtë Projekt Statut për ndryshim nga Statuti aktual propozohen si vendbanime të reja të shtohen Jeta e Re dhe Pojata (i njohur si Rubovci i Vogël) nga banorët pasi edhe faktikisht ekzistojnë si të tilla ndërsa propozohen të fshihen si vendbanime ndërsa të vazhdojnë të mbesin si zonat kadastrale konform Ligjit për kufijt administrativ fshatrat e pabanuara : Okosnica, Shisharka, Vogaqica , Bukovica dhe Lipovica.

Edhe dispozita e hyrjes në fuqi të akteve të Kuvendit e përcaktuar me nenin 20 paragrafin 20.3 e cili flet për afatin tetë (8) ditor të hyrjes në fuqi ndryshohet dhe mbetet që afati i hyrjes në fuqi i akteve të Kuvendit të Komunës të jetë konform Ligjit dhe akteve nënligjore pasi nga praktika kemi vërtetuar se aktet nënligjore që e rregullojnë këtë çështje disa herë kanë pësuar ndryshime rreth këtij afati .

Me këtë Projekt Statut kemi ndryshime edhe te struktura e brendshme organizative e Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe disa Drejtorateve Komunale që ka shkaktuar ndryshime edhe sa i përket përkrahjes së detyrave të punës në disa Drejtorate Komunale.

Vlen të theksohet se nga ky riorganizim, dy Drejtorate Komunale kanë ndryshuar edhe emërtimin për dallim nga Statuti aktual dhe të cilat janë Drejtoria për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Infrastrukturë .

Sa i përket dispozitave tjera përveq atyre që i cekëm më lartë mbesin të njëjta siq janë në Statutin aktual pasi që janë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Ky Projekt Statut përmban gjithsej IX kapituj dhe 75 nene.

Nga të cekurat më lartë propozojmë miratimin e Statutit të ri të Komunës së Lipjanit.

INr. 020 - 75773

Lipjan, më 13.12.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

